



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 17.10.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Evgjëni Thaçi-Dragusha dhe Sërgjan Mitrovic.

Munguan: Elmi Reçica dhe Zafir Berisha.

Pjesëmarrësit e tjerë: Erëblina Ajazi, praktikante, Vlora Nushi, OPA/UNMIK, Adem Gashi USEP, Bleronë Hoxha, Violeta Haxholli KDI, Egzon Osmanaj, MD, Blerta Bejtullahu EUSR/EU Office dhe media.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë për dialogun;**
3. **Shqyrtimi i vlerësimeve të sindikatës së MPJ-së në lidhje me shkeljet në shërbimin e jashtëm;**
4. **Shqyrtimi i mundësive të aplikimit të Kuvendit të Kosovës në disa organizata parlamentare;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë për dialogun;

Vjosa Osmani -Sadriu, njoftoi se raporti i Qeverisë është hartuar nga ish-ekipi negociatorë që është udhëhequr nga z. Avni Arifi, i cili tashmë është propozuar për ambasador dhe se kjo është arsyeja se pse ka qenë e pamundur që ai të ftohet për raportim, ndërkaq personi i ri i propozuar z.

Fatmir Limaj, nuk ka qenë i përfshirë në procesin e dialogut. Ajo tha se pavarësisht mendimeve të ndryshme që mund të kenë për marrëveshje të caktuara, ekziston nevoja që të vlerësohet ky proces 7 vjeçar i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Osmani, po ashtu, njoftoi se ka kërkuar nga Kryeministri që t'i dërgojë të gjitha marrëveshjet e arritura në këtë proces, të cilat i ka dërguar, mirëpo, ekzistojnë një varg dokumentesh, të cilat janë diskutuar në publik, qarkullojnë në disa institucione, mirëpo, Qeveria nuk i posedon. Një prej tyre, tha se është aneksi i marrëveshjes për drejtësi, i cili akoma nuk po bëhet publik dhe sipas Qeverisë ai nuk gjendet në arkivin e Qeverisë. Ajo më tej shtoi se ka edhe marrëveshje të tjera, siç është ajo për produktet farmaceutike, e cila nuk është në dokumentet e dorëzuara nga Qeveria. Osmani propozoi që komisioni t'i adresohet prapë Qeverisë dhe të kërkojë dokumentet që mungojnë, duke shtuar se Këshilli Gjyqësor posedon aneksin në lidhje me zbatimin e marrëveshjes për drejtësi dhe duhet të kërkohet edhe tek institucionet tjera ku ato mund të gjenden. Komisioni duhet të vendos, nëse dëshiron vetëm ta shqyrtojë këtë raport dhe të mos i procedohet Kuvendit, apo, pas shqyrtimit të këtij dokumenti Qeverisë t'i dërgohet një raport me rekomandime. Osmani shtoi se nëse komisioni vendos që t'i dërgojë raport me rekomandime, i cili duhet të miratohet nga Kuvendi, atëherë duhet t'i bëhet një analizë e detajuar marrëveshjeve, ndërsa në lidhje me raportin, tha se ka vërejtje për shkak se i mungon një analizë e detajuar e marrëveshjes së parë të parimeve në mes të dy vendeve, e nënshkruar në vitin 2013, sepse ajo është baza e të gjitha marrëveshjeve pasuese dhe është e vetmja që është ratifikuar në Kuvend.

Osmani në vazhdim theksoi sfidat në zbatimin e marrëveshjeve të arritura në Bruksel: asaj për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, integrimin e policisë, drejtësisë, mbrojtjes civile, në aranzhimet (zyrat ndërlidhëse), në energji, telekomunikacion, çështjet doganore, menaxhimi i integruar i kufijve dhe pikat e përbashkëta të kalimit kufitar, lirinë e lëvizjes/Ura e Mitrovicës, bashkëpunimi rajonal, njohjen e diplomave universitare e kadastrën.

Sa i përket marrëveshjes së vitit 2013, ajo tha se ndër pikat themelore është pjesa e drejtësisë, aty thuhet që deri në qershor të vitit 2013, të dyja palët do të miratojnë Ligjin për Amnisti, duke theksuar se Kosova e ka miratuar atë menjëherë, mirëpo, kanë kaluar 5 vite dhe akoma askush nuk kërkon nga Serbia që ta zbatojë këtë obligim. Nëse e shprehet në përqindje moszbatimin e marrëveshjeve nga ana e Serbisë, ajo mund të arrij në mbi 90%. Sa i përket Kosovës, edhe në raportet e fundit ndërkombëtare, zakonisht flitet vetëm për moszbatimin e marrëveshjes për asociacionin e komunave serbe dhe se i ka zbatuar obligimet e veta që dalin nga të gjitha marrëveshjet e tjera.

Time Kadrijaj, tha se Qeveria iu ka përgjigj në momentin që komisioni ka kërkuar raportin për të arriturat dhe sfidat e marrëveshjeve të arritura në Bruksel. Ajo shtoi se të gjitha marrëveshjet janë arritur në mandatet e kaluara dhe se nuk e sheh të arsyeshme që një raport me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për debat, pasi që në Kuvend tashmë është debatuar për këto marrëveshje. Kadrijaj shprehu mendimin se ka sfida në zbatimin e marrëveshjeve, se janë në dijeni për përqindjen e moszbatimit të këtyre marrëveshjeve dhe se raporti i Qeverisë është një raport informues.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se nuk ka pasur vlerësim të marrëveshjeve në tërësi deri më sot dhe njoftoi se ka pas debat para marrëveshjes për drejtësinë të vitit 2013, mirëpo, për shumicën dërmuese të marrëveshjeve tjera, asnjëherë nuk ka pasur analizë. Lidhur me analizën e propozuar për marrëveshjet, Osmani tha se bëhet fjalë për një analizë profesionale, për të cilën do të duhej të angazhohen edhe ekspertë. Ajo shtoi se deri më sot nuk ka pasur vlerësim të procesit dhe se bëhet fjalë për një dokument i cili do të duhej të miratohet nga Kuvendi, në lidhje me komplet procesin.

Glauk Konjufca, procesi i dialogut me Serbinë tha se ka pasur shumë defekte. Fillimisht numri i personave përgjegjës për raportim në Kuvend dhe numri i takimeve të tyre me zyrtarët e Serbisë, është në shpërprurje të plotë. Transparenca dhe raportimi në Kuvend për çdo takim me zyrtarë të Serbisë ka dështuar dhe nuk është zbatuar fare. Pas leximit të raportit, tha se vërehet se ky raport

ka defekte, si mospërmbushje të marrëveshjeve, ngecje në zbatim të tyre kryesisht me obstrukcione nga ana e Serbisë. Konjufca duke ju referuar tekstit të raportit të Qeverisë, ku thuhet se Qeveria pret që Serbia të shpërbëjë strukturat paralele, theksoi se është pesimist se Serbia do ta bëjë këtë. Lidhur me integrimin e pjesëtarëve të MUP-it serb, tha se ne si deputetë duhet të dimë se cili ka qenë kriteri i pranimit të tyre nga policia e Kosovës. Po ashtu, theksoi se konstruktimi i kornizës së Marrëveshjes së Brukselit, sipas tij, është ndarje e pushtetit me Serbinë, duke pasur parasysh faktin se Serbia ka të drejtë të propozojë emrin e komandantit të Policisë së Kosovës, sipas asaj marrëveshjeje. Konjufca tha, se sipas Aneks marrëveshjes për drejtësinë, e cila nuk është bërë publike, aktgjykimet e Serbisë deri më 15 korrik 2013, konsiderohen të vlefshme. Në raport shtoi ai, thuhet se mbrojtja civile është shpërbërë dhe pjesëtarët e saj janë integruar në institucionet e Kosovës, ndërsa asnjëri prej tyre nuk i përgjigjet ligjit. Konjufca, më tej ceku edhe sfidat lidhur me marrëveshjen për doganat, me vendosjen e vulave doganore që nga viti 2011, e të cilat tha se ende vazhdojnë të jenë të njëjta, sfidat lidhur me pikat kufitare si dhe theksoi ndaljen e pjesëtarëve të policisë dhe FSK-së, me rastin e kalimit të kufirit me Serbinë, pastaj marrjen në pyetje të tyre. Duke pasur parasysh sfidat gjatë këtij procesi, ai theksoi se ky proces nuk mund që quhet i normalizimit të marrëdhënieve dhe përkrah propozimin që komisioni të del me rekomandime, në mënyrë që Qeveria të ndryshoj kahen e përcaktimit politik, karshi këtij procesi.

Vjosa Osmani -Sadriu, në lidhje me Aneksin e marrëveshjes për drejtësinë, tha se fakti që ajo i referohet vlefshmërisë së aktgjyqimeve deri më 15 korrik 2013, tregon se nuk është aneks i marrëveshjes së vitit 2015, por aneks i marrëveshjes së vitit 2013, vetëm për zbatimin e pjesës së drejtësisë.

Dukagjin Gorani, theksoi se nuk e ka të qartë pse duhet të bisedohet kaq gjatë ky raport në komision, meqë është një tekst i përsëritur dhe i njohur për opinionin publik këto 7-8 vitet e fundit. Ky raport mundohet me paraqit një gabim të qëllimit logjik, ku përparimet e vogla të parëndësishme duhet ta krijojnë një përshtypje të caktuar publike. Ai tha se raporti i cili është i kopjuar nga një raport tjetër dhe është sjellë sot në komision për t'u diskutuar, nuk e kupton se çfarë rezultati do të prodhojë. Sa i përket marrëveshjeve të vitit 2013 dhe saktësisht të tyre përmes marrëveshjeve të vitit 2015, tha se çka do që mund të bëhet rreth atyre marrëveshjeve, ky komision nuk do të mund t'i zgjidh.

Vjosa Osmani- Sadriu, theksoi se arsyeja e shqyrtimit të këtij raporti është detyrim i Kuvendit për ta mbikëqyr punën e Qeverisë, e në veçanti detyrë e komisionit që ta mbikëqyrë Qeverinë në fushën e politikës së jashtme, ku bënë pjesë edhe dialogu. Deri më tani, tha se Kuvendi nuk ka prodhuar asnjë raport me rekomandime lidhur me procesin 7 vjeçar të dialogut Kosovë–Serbi, përderisa në një sistem parlamentar dokumenti për një proces kaq të rëndësishëm duhet të përfundojë në Kuvend, e jo në Qeveri.

Evgjeni Thaçi -Dragusha, tha se procesi i vlerësimit të dialogut nuk është i nevojshëm, pasi që vet Qeveria e ka dhënë progresin dhe sfidat lidhur me të. Prosesi i dialogut i ndërmjetësuar nga BE-ja, tha se nuk është vetëm bardh e zi por një e arritur e madhe nga fakti se ulen në bisedime dy shtete të barabarta. Më tej, ajo tha se nuk mund të jepen rekomandime për disa marrëveshje që tani më janë fuqi, por duhet bërë rekomandime në projekt-rezolutat të cilat i kemi në tavolinë, për të kontribuar në procesin e dialogut. Thaçi-Dragusha, theksoi se nuk do të marrë pjesë në votim me rastin e hedhjes në votim të rekomandimeve, në lidhje me procesin e marrëveshjeve të arritura.

Vjosa Osmani-Sadriu, e hodhi në votim propozimin që Komisioni të hartojë raport me rekomandime, pas një analize të detajuar që ja bën procesit dhe marrëveshjeve të arritura gjatë këtyre shtatë viteve.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

Përfundim

Propozimi i Komisionit për hartimin e një raporti me rekomandime, pas analizës së detajuar të procesit të dialogut dhe marrëveshjeve të arritura gjatë këtyre shtatë viteve, nuk miratohet, në mungesë kuorumi me rastin e votimit.

Me rastin e votimit, të pranishëm ishin 7 anëtarë të komisionit, nga të cilët "për" votuan 5 anëtarë, ndërsa anëtarët Time Kadrijaj dhe Danush Ademi, nuk iu nënshtruan procesit të votimit.

3. Shqyrtimi i vlerësimeve të sindikatës së MPJ-së në lidhje me shkeljet në shërbimin e jashtëm;

Vjosa Osmani Sadriu, tha se nga SHSASHJ, na është përcjellë një shkresë, e cila i përmban shqetësimet e kësaj shoqate, rreth punës së MPJ-së. Ndër këto shqetësime, është vazhdimi i mandatit për stafin diplomatik/konsullor, ku thuhet se janë nxjerrë 40 vendime për vazhdimin e mandatit të stafit në misione diplomatike/konsullore, shumica nga të cilët e kanë përfunduar mandatin katërvjeçar e gjenden në vitin e 5 e të 6 në të njëjtin mision, gjë që e konsiderojnë si formë arbitrare të vendimmarrjes dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Shqetësim tjetër shfaqin, lidhur me parregullsitë në gradimet dhe emërimet në misione diplomatike/konsullore. Ata kanë paraqitur edhe një analizë të Raportit të KGD-së, lidhur me takimin e mbajtur më 1-2 mars 2018, ku kanë identifikuar shkeljet dhe mangësitë e tjera.

Znj. Osmani-Sadriu, theksoi se shumica e këtyre shqetësimeve janë ngrit gjatë raportimit të ministrit të jashtëm, megjithatë ato vazhdojnë të ndodhin dhe njoftoi anëtarët e komisionit se ministri i jashtëm është ftuar për raportim në Komision pas mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për qëndrimet e tija në takimet që i kishte gjatë aktivitetëve dhe për tema të tjera nga fushëveprimi i shërbimit të jashtëm, mirëpo, përgjigjja e tij ishte se ndodhet jashtë vendit dhe se do t'i përgjigjet ftesës në momentin që gjendet në Kosovë.

Dukagjin Gorani, lidhur me shkresën nga SHSASHJ-ja theksoi se nuk di se cilat janë instrumentet që i kemi në dispozicion karshi situatave të tilla.

Vjosa Osmani-Sadriu, theksoi se ministri për këtë çështje mund të ftohet në interpelancë dhe kjo çështje mund të shqyrtohet edhe nga grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve e po ashtu, komisioni do të angazhohet që ministri të vijë në raportim në Komision.

Evgjeni Thaçi- Dragusha, këto shqetësime tha se i kemi ngritur si Komision edhe më parë, kur ka qenë ministri në raportim, por përgjigjja e tij ka qenë se kështu e ka gjetur ministrinë. Ajo propozoi që në lidhje me këto shqetësime të gjendet zgjidhja.

Fitore Pacolli, njoftoi se detyrën e kryesueses së grupit punues e ka marrë në mbledhjen paraprake, dhe se posa të njoftohet me gjendjen, do ta ftojë takimin e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Dukagjin Gorani, rreth vlerësimeve të SHSASHJ-së, propozoi që të mbahen takime të mbyllura me anëtarë të sindikatës, për të krijuar argumente për procedura të mëtejme.

Vjosa Osmani- Sadriu, theksoi se grupi punues mund të ketë takime joformale me sindikatën dhe varësisht nga vullneti i tyre, mund të ftohen edhe në Komision. Këto çështje, tha se do të trajtohen edhe kur të vijë ministri në raportim në komision.

4. Shqyrtimi i mundësive të aplikimit të Kuvendit të Kosovës në disa organizata parlamentare;

Vjosa Osmani- Sadriu, njoftoi anëtarët e komisionit se nga takimet që ka me deputetë të shteteve të ndryshme, janë identifikuar disa organizata ndërparlamentare në të cilat Kuvendi i Kosovës asnjëherë nuk ka aplikuar, përderisa shtetet e rajonit janë anëtare të tyre. Duke pasur parasysh rëndësinë e anëtarësimit në këto organizata, ajo propozoi që stafi së bashku me Drejtorinë për Marrëdhënie Ndërkombëtare e Protokoll, të bëjnë identifikimin e organizatave ndërparlamentare, në të cilat Kuvendi nuk është anëtar.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Drejtoria për Marrëdhënie Ndërkombëtare e Protokoll e Kuvendit, së bashku me stafin e komisionit, brenda dy javëve të identifikojnë organizatat ndërparlamentare, në të cilat Kuvendi i Kosovës nuk është anëtar.

5. Të ndryshme.

Evgjeni Thaçi- Dragusha, njoftoi se grupi punues është në përfundim e sipër të raportit nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Diasporën dhe Mërgatën dhe pas përmbylljes së punës së grupit, do t'ia procedojë Komisionit për shqyrtim.

Vjosa Osmani Sadriu, njoftoi se Komisioni për Legjislacion, ka formuar një grup punues, ku do të trajtohet edhe çështja e të drejtës së votës së diasporës dhe ndryshimet që janë të nevojshme në Ligjin për zgjedhjet, sa i përket diasporës dhe bëri të ditur se në konsultim me kryetaren e Komisionit për Legjislacion, ka propozuar që grupi punues të jetë i përbashkët për dy komisionet, meqë edhe komisioni ynë është duke e trajtuar këtë çështje.

Pas këtij njoftimi, Komisioni vendosi që në këtë grup punues të merr pjesë deputetja Doruntina Maloku- Kastrati, ku mund të përfshihen edhe anëtarët e tjerë të komisionit.

Time Kadrijaj, theksoi se në Komision kemi pasur një qëndrim, që të mbajmë një takim të përbashkët të komisionit me KQZ-në dhe ministrin, në lidhje me diasporën, për të cilën çështje është njoftuar edhe diaspora.

Vjosa Osmani Sadriu, tha se Komisioni nuk është takuar ende me KQZ-në, duke pasur parasysh se ende nuk kanë kuorum dhe rasti është në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim. Ajo theksoi se ky takim do të mund të mbahej me kryetaren e KQZ-së dhe pjesëtarë nga sekretaria e tyre, ku do të mund të ftohet edhe grupi punues nga Komisioni për Legjislacion, në momentin kur shumica e anëtarëve të komisionit do të mund t'i përgjigjen ftesës së pjesëmarrje në takim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

Kryetarja e Komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.